



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1400/ 1 prot.,

Datë 02.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Murati” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatrave Zogjaj, Bllacë dhe Shtushaj në Njësinë Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë” me Nr. REF-42951-03-28-2025, me fond limit: 41.523.333 (dyzetë e një milion e pesëqind e njëzetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.04.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Murati” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT J66702413V dhe K66613407H me adresë: Rruga “Ish Keshilli i Rrethit Bulqize”, “Lagjja e Re”, Banesa Nr. 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Ap. 1, Bulqizë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Bulqizë.
Adresa: Lagjja “Minatori” Bulqizë.

Në datë 30.05.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2025/5363 dhe me nr. 1400/2025 Prot., date 02.06.2025 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Murati” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Sistemim-asfaltim i rrugëve të fshatrave Zogjaj, Bllacë dhe Shtushaj në Njësinë Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë” me Nr. REF-42951-03-28-2025, me fond limit: 41.523.333 (dyzetë e një milion e pesëqind e njëzetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.04.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Bulqizë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Murati” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Murati” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK:

- OE nuk ploteson kriterin 2.3.11, Linje Asfalti e pajisur me leje mjedisore (Ne pronesi, me qera ose me kontrate furnizimi). Kontrata e furnizimit e dorezuar nga OE mban datën 05/05/2025 me numer repertori 5000 dhe numer koleksioni 3784. Pra kjo kontrate nuk ka qene e lidhur para datës 16/04/2025 kur është bërë dorezimi i ofertave në këtë procedurë prokurimi..

Gjithashtu bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ngrenë pretendime edhe për afatin e dorezimit të dokumentacionit datë 08/05/2025 ora 14:00 i caktuar nga autoriteti kontraktor është një afat i pambeshtetur në ligj dhe tendencioz .Me vendosjen e këtij afati kohor autoriteti kontraktor e ka vendosur në pamundësi absolute ankuesin për të përmbushur detyrimin e për dorezimin e dokumentacionit.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 02.06.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri